




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Në bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, pas kërkesës nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Kamenicës bënë këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Titulli i pozitës: Një (1) Specialist i Radiologjisë.

Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues

Paga bruto mujore: 770 €.

Periudha e angazhimit: (120 ditë)

Detyrat Kryesore:

- Kryen kontrolle dhe ekzaminime radiologjike
- Siguron që ekzaminimet të bëhen sipas standardeve profesionale dhe protokolleve.
- Analizon imazhet radiologjike dhe vendos diagnozën përfundimtare.
- Përgatit raporte mjekësore për pacientët dhe mjekët referues
- Siguron që ekzaminimet të kryhen në kohë sa më të shkurtër
- Në raste urgjente, kryen interpretim dhe diagnozë menjëherë
- Udhëzon teknikët e radiologjisë për përdorim korrekt të pajisjeve
- Kujdeset për minimizimin e ekspozimit ndaj rrezatimit për pacientët dhe stafin
- Bashkëpunon me mjekë të tjerë (mjekë familjarë, specialistë të fushave tjera) për diagnozë dhe trajtim
- Ka detyrim të përditësojë njohuritë dhe të ndjekë zhvillimin profesional të vazhdueshëm
- Kryen edhe detyra të tjera sipas nevojave të institucionit.

Kualifikimi:

Diplomë e arsimit (Baçelor) Radiologjisë - Specialist i Radiologji (dëshmi), përvoja e punës (e dëshirueshme)
Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin (kopje) si vijon:

Formulari i aplikimit, i plotësuar;

Dëshmi të kualifikimit Arsimor;

Dokumentin e identifikimit.

Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka);

Dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje; (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamenicës.

Afati i aplikimit është 7 ditë, nga dita e shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve.

"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike lokale".

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kriterëve të shpalljes Publike përmes njoftimit në Web faqe Komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Kadri RAHIMAJ

Kryetar i Komunës Kamenicës